



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 55

Prishtinë, më 20.10.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Naim Maloku, Myrvete Pantina, Haset Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi, Dragiša Mirić, Ali Lajçi, Elheme Hetemi.

Munguan : Zef Morina, Zulfi Merxha.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Ministri Mahir Yagcilar me bashkëpunorë, vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Ministri i MMPH për termocentralin “Kosova e Re”,
3. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshim/plotësimin e ligjit për Pyjet,
4. Të ndryshme (propozimi i Naim Malokut për shqyrtimin e “rrezatimeve jonizuese”).

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Lulzim Zeneli** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**2. Ministri i MMPH për termocentralin “Kosova e Re”**

**Lulzim Zeneli** falënderoi ministrin për përgjigje në ftesë dhe ftoi që të paraqet pikëpamjet e MMPH rreth termocentralit të projektuar.

**Mahir Yagcilar** gjithashtu falënderoi dhe fillimisht sqaroi rastet kur është e domosdoshme të hartohet VSM (vlerësimi strategjik mjedisor) për një projekt i cili shkakton dëme në mjedis. Në këtë rast ai kërkoi falje që nuk është zbatuar neni 21 i Ligjit për VSM, ngase në kohën e projektimit nuk ka ekzistuar ligji në fjalë, kurse tani këtë do ta bëjë ministria së më shpejt që

është e mundur për Kuvendin e Kosovës me gjithë kontradiktat e shfaqura, por ai nuk precizoi kapacitetin që do të bëhet ky termocentral, ngase kjo varet nga ministritë tjera dhe përfundimisht Qeveria, e cila do ta kontrakttoi vendin dhe kapacitetin përfundimtar. Gjatë qershorit 2008, vazhdoi, kjo ministri ka pranuar raportin nga ministria energjetike për të cilin ka pas pajtim të gjithanshëm dhe është punuar po në atë mënyrë. Në vazhdim janë pranuar edhe raportet tjera për vlerësime tjera të ekspertëve por edhe të grupit ndërministror duke u bazuar në mihjen e re në bazë të zonës strategjike të shpallur nga ministria e energjisë, janë organizuar dëgjimet e ndryshme publike me ekspert, me komunitetet përkatëse, OJQ, KEK etj.

**Ali Lajçi** tha se mbrojtja e mjedisit është komplekse te ne, sidomos në rastin e synimit të ndërtimit të “Kosova e re” që parashtron droje për koston dhe shumë plotësime të standardeve që kërkohen, sidomos nga BE, ndaj ai mendon se ky projekt është punuar pa u menduar mirë. Koha e thëngjillit pasi që tani konsiderohet se është tejkaluar, shtrohen pyetjet sa kemi me pas pasoja.

**Lulzim Zeneli** tha se komisionit i intereson impakti në mjedis dhe vlerësimet që do të ketë në mjedis ky termocentral me kapacitetin të cilin ende nuk e ka qartësuar Qeveria, si është bërë vlerësimi, a ka ndikim në mjedis apo nuk ka, nëse ka sa është ky ndikim etj.

**Naim Maloku** fillimisht tha se çdo gjë që ndërtohet në mjedis, qoftë edhe një pikë e karburantit, duhet të shkoj me lejen e MMPH, ndaj parashtrori dilemat : sa është kapaciteti që duhet të ndërtohet, ndikimi në mjedis që do bëhet a do të jetë brenda kornizës së BE, a ka garanci nga ministria se do të respektohen parametrat e BE-së dhe nëse jo, a do të ketë mundësi që të mbyllet objekti nëse nuk respektohet BE etj. Ai tha se paqartësitë janë sidomos në faktin se ndotje do të kemi por më pak dhe me shumë pikëpyetje.

**Heset Cakolli** konstatoi se kapacitete të reja duhet të ndërtohen por me një studim detal, sidomos kur kemi parasysh përdorimin e thëngjillit. Ai pyeti se a janë ende aktuale dhe të zbatueshme në BE standardet e paraqitura në tabelën 3 të materialit të dorëzuar, dhe a do të zvogëlohen këto standarde.

**Myrvete Pantina** parashtrori nevojën e përbashkët për rrym por me kapacitet që mund ta përballoi Kosova.

**Mahir Yagcilar** në vazhdim u përgjigj pyetjeve me konstatim se për këtë problematikë është deshtë më shpesh të takohet komisioni me ministri. Ai tha se përgjigjet varen edhe nga subjektet tjerë qeveritar që i cekin në fillim dhe gjërat tjera teknike të cilat duhet të kompletohen dhe në fund të veprohet. Grupi ndërministror në ndërkohë është takuar me ekipin konsultativë dhe pritet të bëhet kontrata përfundimtare me fituesin e tenderit që do të sqaroi edhe pyetjet e bëra në këtë takim (kapaciteti etj). Sa i përket ndotjes së mjedisit ai pohoi se do të ketë ndotje por shumë më pak dhe të kontrolluar, sepse tani ende nuk ka aparate për vërtetimin e ndotjes së ajrit. Së shpejti do të promovohet stacioni i parë për kontrollimin e ajrit. Për parametra ai tha se duhet të jenë Evropiane gjithsesi, sidomos ajo e paraqitur në tabelën e cekur. A do të mund të shkëputet kontrata, kjo gjithashtu do të varet nga Qeveria se si e kontraktton.

**Lulzim Zeneli** tha se në këtë takim kuptuam se Qeveria do të rishqyrtoi vendimin e vet për kapacitetin e termocentralit, por ai tha se komisionit i intereson zbatimi i ligjit, konkretisht neni 21 i Ligjit për VSM me çka MMPH obligohet ta dërgoi raportin e VSM Kuvendit në afatet e caktuara kohore, si dhe të hiqen dilemat që thuhet në opinion si p.sh. do të aplikohen teknologjitë e avancuara sa i përket CO<sub>2</sub>-shit por në anën tjetër është konstatimi se testimi do të bëhet me 2015. MMPH duhet të luaj rolin e avokatit dhe të minimizoj ndotjet që kanosen. Në fund shprehu mendimin se vendi ynë nuk mund të përballoi kapacitetin më tepër se 500 MW.

**Berat Luzha** tha se gjendja në Obiliq është katastrofale për çka MMPH duhet të bëjë diçka, sidomos për zhvendosjen e popullatës brenda 10 km, ndërsa KEK më në fund duhet të respektoj parimin ligjor “ndotësi paguan”, ai u pajtua me kapacitetin 500 MW sepse së pari duhet të kemi ne rrym për vedi pastaj të veprojmë gradualisht për përmirësim të gjendjes.

**Elheme Hetemi** tha se është një shqetësim që mundon të gjithë, por ajo duke mos kundërshtuar projektin kërkoi që MMPH të jap vlerësimet e ndikimit në mjedis duke monitoruar kriteret që janë paraparë me standardet e BE-së.

**Mahir Yagcilar** vazhdoi në kuadër të pyetjes së zj. Hetemi duke konstatuar se MMPH duhet të nxjerr udhëzime për ndalime të ndryshme, pastrimin e hirit dhe shumë probleme të grumbulluara që nga viti 1960, por ai shpreson për ma mirë pasi të promovohet stacioni i parë për kontrollimin e ajrit. Problemet e cekura këtu fatkeqësisht i përcjellin edhe problemet tjera siç janë ato sociale dhe të kushtueshme. Kjo Qeveri nuk mund të investoi në çdo cep të mjedisit por gradualisht duke i pasur parasysh faktorët ekzistues.

Kryesuesi falënderoi dhe ftoi në bashkëpunim sa më të përafërt.

**Selvie Halimi** kërkoi fjalën rreth projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja duke kërkuar nga komisioni të deklarohet rreth propozimit për dëgjim publik.

**Naim Maloku** rikujtoi të pranishmit se gjatë leximit të parë të projektligjit në fjalë nuk ka pasur vërejtje të përmasave shqetësuese të cilat do të shtynin komisionin të kërkoi sqarime shtesë rreth projektligjit, ndaj sugjeroi që GP të vazhdoi punën me vërejtjet eventuale ekzistuese. S. Halimi caktoi takimin për të martën në orën 11,00 duke ftuar MMPH dhe OSCE.

## **2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Pyjet**

**Lulzim Zeneli** fillimisht kërkoi sqarime nga **Berat Luzha** i cili njoftoi komisionin me disa propozime nga MB por duke konstatuar se ka mjaft shqetësime dhe më kryesorja : si do të barten kompetencat tek komunat, konkretisht. Propozoi edhe një dëgjim publik përmes mbështetjes së OSCE dhe OJQ-ve ku do të jetë pjesëmarrës edhe ky komision dhe në fund të sugjerohen konkluzionet për komisionin.

**Elheme Hetemi** tha se në grupin punues janë të qarta shumë gjëra tani por mbeten dy çështje : zbatimi i ligjit me kompetenca të padefinuara, dhe definimi me ministrin Vehapi të kompetencave të AKP të cilat kërkohen të kalojnë në kompetenca komunale. Ajo mendon se më tutje mirë është të ftohet ministri me të cilin duhet të sqarohen këto gjëra dhe të precizohen, sepse nuk mund të presim më.

**Lulzim Zeneli** tha se reformat duhet ti përshtaten ligjit dhe propozoi një tryezë pune për sqarimin e gjërave me zyrtarët që mund të kontribuojnë, përndryshe ky ligj to të mbetet për vitin e ardhshëm.

Në vazhdim komisioni në formë debati me diskutime të shkurta dhe të gjithanshme konstatoi se duhet të caktohen qartë kompetencat e APK dhe të komunave duke cekur se niveli komunal kërkon menaxhim ndërsa ai qendror politikëbërje.

**Naim Maloku** tha se propozimet e MB nuk janë për tu hedhur , ngase ata sugjerojnë rregullimin e nenit kyç (29) : mbrojtja dhe dhënia e licencave, gjithashtu konstatoi se disa propozime nga komunat nuk mund assesi të miratohen p.sh. eliminimin e APK. Ai propozoi që komunave të dërgohen këto dy propozime : a pajtohen apo kanë ndonjë shtesë, nëse jo të përmbillet kjo çështje me shndërrimin e dy propozimeve në amendamente nga komisioni. Ai përfundoi me konstatimin se nuk duhet të kemi në ligj “kompetenca të deleguara” ngase sjellin mjegulli por duhet të kemi vetëm kompetenca ose kuptimi negativ.

**Berat Luzha** tha se nuk është problem vetëm neni 29 i ligjit por ka mjaft probleme për çka edhe më mirë kishte qenë të hartohet një ligj i ri.

Komisioni nxori :

### **K O N K L U D I M**

**Grupi punues për këtë projektligj të vlerësoi si të veproi në vazhdim komisioni, që mundësisht në takimin e radhës në komision të vendoset për veprimin e mëtejme.**

**Berat Luzha** tha se do të takohet me ministrin e bujqësisë për të diskutuar çështjet kontestuese dhe për veprimet e mëtejme.

### **3. Të ndryshme**

#### **Projektligjin për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare**

**Kryetari dhe nënkryetari i komisionit Naim Maloku** konstatuan se ky projektligj mund të procedohet më tutje në komisionin kryesor ku është kërkuar rivlerësimi nga ky komision, me 13 amendamente të pandryshuara. Arsyetimi do të pasoi sipas nevojës, gjatë seancës plenare.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,55. Mbledhja e radhës do të mbahet më 27.10.2009.

Kryetari i Komisionit,  
**Lulzim Zeneli**